

**Plan dhe Program**  
**për zgjidhjen e problemit me kafshët e pa strehë**  
**në territorin e Komunës Kërçovës**

## **1.Hyrje**

**Në kompetencë të Komunës së Kërçovës është mbrojtja dhe mirëqenia e kafshëvenëve të pa strehë me këtë plan dhe program që ka për qëllim të përcaktohen aktivitetet në korniza të asaj kompetence, për trajtimin e kafshëve endacak, kushtet, organizimin si dhe mënyrën e financimit të aktiviteteve programore.**

Programi për zgjidhjen e problemit me kafshët e pa strehë -trajtimi i qenëve endacak, gjegjësisht qenë të regjistruar dhe të pa regjistruar, të gjendur në sipërfaqe publike pa prani të pronarit, është në pajtueshmëri të 26,27,28,29 dhe neni 30 nga Ligji për mbrojtje dhe mirëqenien e kafshëve („Gazeta Zyrëtare e RM“ nr.149/14;149/15 dhe 53/16) dhe obligimet e komunës të cilat dalin nga i njejti ligj.

Për zgjidhjen e problemit lidhur me rritjen e numrit të kafshëve të pa strehë, gjegjësisht mbajtjen nën kontrollë të numrit të tyre, nga ana e Organizimit shëndetësorë botërorë, si e vëtmja mirmbajtje efikase është propozuar trajtimi në mënyra humane të këtyre kafshëve, d.m.th sterilizimi masovik i tyre , vakcinimi dhe përsëri kthimi i tyre në teritorin e mëparëshëm.

Komuna e Kërçovës çdo vit përgadit dhe realizon programin me të cilin kryejmë kapjen e tyre dhe sterilizimin/trajtimin dhe vaksinimin e kafshëve të pa strehë, d.m.th të gjitha kafshët në liri në një territor të caktuar. Pas sterilizimit/kastrimit dhe vaksinimin e kafshëve të njejtit kthehen në teritorin e mëparëshëm dhe ku vazhdojnë të jetojnë.

Pas sterilizimit/kastrimit të gjitha kafshët janë të vaksinuar, shënuar ( me marker në vesh ose me çip), të fotografuar dhe regjistruar.

## **2. Principe themelore:**

Komuna e Kërçovës si mbartës themelues i këtijë Programi dhe subjekteve relevante ne zgjidhjen e problemit me kafshët e pa strehë në teritorin e vet, udhëhiqen nga parimet vijuese:

**Parimi për kontinuitet-Program dhe strategji.**

**Parimi Univerzal**-Programi ndërlidhet me trajtimin gjithpërfshirës dhe kalimin/zgjidhjen e problemit në lidhje me strehimin e kafshëve të pa strehë, strehimin joadekuat të tyre dhe shumimin e tyre të pa kontrolluar, si dhe ikjen dhe mospërfilljen, probleme të cilat janë në masë më të gjërë arsyёja kryesore përritjen e numrit të kafshëve të braktisura. Nga ato arsyёe eshtë e rëndësishme që të merren masa të cilët dë të jatin rezultate në rritjen e përgjegjësisë ndaj pronarëve të kafshëve.

Shërbimi komunal i kujdestarisë bëri numrimin në teren me çka kemi numër të 500 qenëve të numëruar endacakë në rajonin e Komunës së Kërçovës. Shërbimi komunal i kujdestarisë do të vazhdojë të bëjë kontolle në teren përzbatimin e obligimeve të qytetarëve në pajtueshmëri me Vendimin përrend komunal.

-Detyrimi për identifikimin dhe regjistrimin e kafshëve shtëpiake

-Mbrojtja e tyre nga egërsimi dhe neglizhenca, menyra e strehimit dhe strehim sipas kushteve adekuate për cdo lloj të qenëve në sipërfaqen e tyre të jashtëme.

-Do të ndalohet shumimi i tyre i pakontrolluara i qenëve të tyre përvëq në kushte të regjistruar të mbikçyruara.

-Parashikohen sanksione përritjen e kafshëve shtëpiake.

Komuna \_\_\_\_\_Kërçovës\_\_\_\_\_ në bashkëpunim me institucionet lokale arsimore dhe sociale, do të prezantojë kategoritë më të reja të qytetarëve me detyrimet etike dhe ligjore të pronarëve të kafshëve shtëpiake përmes leksioneve edukative.

**Parimi i Qëndrueshmërisë** - Programi krijon një sistem kontrolli dhe në këtë mënyrë redukton popullimin e kafshëve të pa strehë në vendbanimet e komunave, me të cilat do ti zgjedhim këto probleme përgjithmonë, dmth do të ketë kontroll të vazhdueshëm mbi ta;

Arsimimi eshtë një prej zgjidhjeve afatgjate dhe pozitive për kontrollimin e këfshëve të pa strehë, prandaj nga rëndësia fundamentele eshtë e nevojëshme promovimi i kampanjave edukative të drejtuara kundrejt promovimit të koegzistencës konstruktive dhe të bashkëjetesës

midis njerëzve dhe kafshëve dhe sjellja e përgjegjëshme ndaj kafshëve. Që të arrihen rezultatet e theksuara, është e nevojëshme që ne këto kampanja përveq pronarëve të kafshëve shtëpiake, të përfshihen të gjithë qytetarët (të rritur, të ri dhe fëmijë) me përfshirjen e të gjithë aktorëve relevant (p.sh. shkollave dhe mediumeve), si dhe njerëz të cilët punojnë me kafshë. Aspektet kryesore udhëhiqen si në vijim:

- Të inkuadrohet koncepti i pronësisë së përgjegjëshme, rëndësia e sterilizimit, vaksinimi, identifikimi dhe regjistrimi;
- Të bëhet inkurajimi i pronarëve që ti sterilizojnë, vkasinojnë, ti identifikojnë dhe ti regjistrojnë kafshët e tyre;
- Të inkurajohen dhe të promovohen praktikat më të mira nga vendet fqinjë;
- Të promovohet kujdes i përgjegjshëm për kafshët shtëpiake të „mëhallës,,
- Të edukohen qytetarët dhe të promovohet respektimi i nevojave biologjike, psikologjike, dhe etologjike të kafshëve;
- Të inkurajohet vullnetarizmi në qendër pranim dhe mirmbajtje të përgjegjëshme;
- Të inkurajohet blerja e kafshëve shtëpiake;
- Të inkurajohen njerëzit që të denoncojnë çdo keqtrajtim, keqpërdorim dhe vrasje të kafshëve deri te organet kompetente.
- Të trajnohen njerëzit të cilët punojnë me kafshë (si në qendër pranim ashtu edhe në rrugë).

**2.1. Parimi i bashkëpunimit**-Programi realizohet përmes përpjekjeve të përbashkëta dhe bashkpunimin e autoriteteve relevante në nivel lokal dhe shtetërorë, organizatave veterniare, ndërmarrjet komunale dhe para se gjithave shoqata për mbrojtjen e kafshëve.

### **3.Qëllimet themelore të programit:**

#### **3.1. Qëllimet**

Qëllimi kryesor i programit është të **kontrollojë popullsinë e kafshëve shtëpiake** në komunën Kërçovës, me efikasitet, përgjegjsi, humanitet, zgjidhja e problemit në

vazhdimësi që do të garantohet, mbrojtja e shëndetsisë dhe siguria publike e vendbanimeve dhe që të parandalohet krijimi/hyrja e qenëve të ri në rrugë përmes:

1) realizimit të strategjisë „kap-sterilizo-vaksino-kthej,, të qenëve të pa strehë dhe të gjithë qenëve që do të takohen të vetëm në rrugë dhe

2) plotësimi me lloje të tjera të masave të parashikuara në kornizë të Vendimit për rendin komunal dhe / ose lloj tjetër të aktit ligjore në kompetencë të komunës, me të cilat do të inkurajojnë dhe përcaktojnë mbajtjen me përgjegjësi të kafshëve shtëpiake (ndalimi i shumimit të pakontrolluar të kafshëve shtëpiake, me përashtim në kushte të përcaktuara me Ligjin për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve dhe ndalimin e largimit të tyre)

Zbatimi i këtij programi përcakton dmth. garanton një numër minimal dhe të kontrolluar të qenve të braktisur në vendet publike që e mbrojnë lokacionin nga formimi i njësive të reja ( të pa njoitura për vendbanimin, në gjendje riprodhuese), me çka evidentohen shqetësimet dhe pasojat më të rënda për qytetarët dhe vetë kafshët.

Segment i rëndësishëm i radhës për kontrollimin e drejtë të popullimit të kafshëve të pa strehë është **edukimi i vendbanimit dhe promovimi i masave për sterilizimin e qenëve nga ana e pronarëve të tyre** në pajtim me shkresat e Ligjit aktual

## KUSH JANË ARSYET për paraqitjen e qenëve të pa strehë? Ja disa:

- Pronarë të pa përgjegjshëm;
  - Shumim i tepërt dhe i pa kontrolluar i kafshëve
  - Braktisja e kafshëve
- Mungesë e arsimimit për mjedisin urban;
- Mungesë e arsimimit për të drejtat e kafshëve;
- Menaxhim i papërshatshëm me qendrat e trajtimit (publike/private)
- Mungesa e një kornize ligjore të përshtatshme që do të trajtojë dhe mbulojë të gjitha problemet e theksuara, braktisja e kafshëve (etiketim i përhershëm, vendosja e çipit dhe regjistrimin e pronarëve të kafshëve, edukimi i pronarëve, dënimin e pronarëve të pa përgjegjshëm).

**Ndërtimi i sistemit të kontrollit dhe monitorimit të vazhdueshëm sistematik** për reduktimin e numrit të qenëve të pa strehë, me pjesmarrje të aktive dhe të përgjegjëshme të të gjithë faktorëve social, veçanërisht shoqatës për mbrojtje të kafshëve. Kthimi në lokacionin e njejtë e mbron lokacionin nga migrimi i njësive të tjera me çka parandalohen sëmundje dhe infeksione. Shpenzimet janë të njëherëshme dhe të arsyeshme, nuk ka shpenzime të pa nevojëshme për trajtim të përhershëm të kafshëve në qendër për trajtim.

Me akte pozitive të zakonshme të cilët do ta përfshinë pronësimin e përgjegjshëm dhe aplikimin e sterilizimit/kastrimit, problemi zgjidhet në mënyrë efikase, humane dhe të përherëshme.

Segmenti vijues i rëndësishëm për arritjen e kontrollimit të popullimit të kafshëve të pa strehë është **edukimi i vendbanimeve dhe promovimi i masave për sterilizimin e qenëve nga ana e pronarëve të tyre** në pajtim me shkresat ligjore adekuate dhe masa kundër braktisjes së kafshëve (etiketim i përhershëm, vendosjen e çipit dhe regjistrimin e pronarëve të kafshëve, edukimi i pronarëve, dënimin e pronarëve të pa përgjegjshëm)

#### **4. AKTIVITETE TË PLANIFIKUARA**

Aktivitetet për trajtim human të kafshëve shtëpiake në territorin e Komunës së Kërçovës nënkuptojnë:

- kapjen e kafshëve,
- transportimin e tyre në stacion,
- pranim dhe kontroll i tyre nga një veterinar,
- testim laboratorik i kafshëve nga sëmundje të caktuara,
- identifikimi dhe udhëheqje të evidencës,
- ovariohisterektomij dhe orhiptomij,
- strehim mbas operacionit, shërim dhe kujdes,
- vakcinim dhe dehelmentacim,
- kthimin e kafshëve në lokacionin e mëparshëm-eutanzimi i kafshëve shumë të sëmura dhe tepër agresivë ndaj mjedisit, përderisa nuk adoptohen,

## **Kapjen dhe transportin**

Procesi i kapjes së kafshëve shtëpiake përfaqson procedurën e parë e cila është drejtpërdrejt e ekspozuar ndaj gjykimit publik. Kualiteti i kapjes , sjellja e personelit ndaj publikut dhe veçanërisht ndaj kafshëve të kapura mund të japë një pasqyrë pozitive për të gjithë aktivitetin, por nga ana tjetër, bashkunim jo korrekt, mund ti traumatojë kafshët, duke quar në dhimbje fizike dhe psiqike, dhe më pas të prodhojë më shumë reaksione të pa dashura nga personat në rrëthimin okulare të cilët kujdesen për qentë e vendit. Përshkak të saj, zgjedhja e personelit duhet të përshtatet me vetë procedurën, personat duhet të trajnohen dhe të çertifikohen për shfrytëzimin e metodave për kapje humane, por para se gjithave të mos ndjejnë armicësi dhe paragjykim ndaj kafshëve të pa strehë, qofshin ato të aftë apo jo për të kontaktuar me njerëzit në një mënyrë e cila nuk do ta kompromisojë aksionin. Përshkak të evidencës, të inçizohet si po shkon kapja.

Punëtorët të angazhuar për kapjen e kafshëve të pa strehë janë të paisur me uniformë bashkohore dhe mjete për mbrojtje personale, si dhe paisje: veturë bashkohore dhe rimorkio, unazore dhe rrjetë për kapjen, pushkë (safari) dhe përkohësisht futjen në gjumë me mjete për paralizë kohore-futje në gjumë, korpa-kafazë për transport, mjete bashkohore dhe paisje për evidentimin dhe identifikimin e kafshëve të kapura.

Transporti nga vendi i kapjes deri te stacionari do të kryhet me automobil special të paisur me paisje bashkohore për strehimin e kafshëve. Uniformat dhe automobili duhet që të jenë të shkruar me shkresat: "Shërbimi për trajtim human dhe kontrollimi i kafshëve të pa strehë" .

## **Komuna e Kërçovës në periudhën e ardhëshme planifikon edhe ndërtimin e një Stacionari**

Çdo kafshë e kapur dërgohet në qendrën për trajtimin e kafshëve të pa strehë, ku duhet të qëndrojë në mbikqyrje klinike, hirurgjike- sterilizimin/kastrimin, vaksinimin, pastrimi nga parazitë të mbrendhshëm dhe të jashtëm. Duhet që çdo kafshë të evidentohet /regjistrohet në databazën e të dhënavë, si dhe shënimin ( me marker në vesh,vendosjae çipave ose kollar të plastiku) në mënyrë që nuk do ti shkaktojnë asnje dhimbje ose traumë. I gjithë trajtimi i theksuar (sterilizimi/kastrimi; dehelmintizimi; vaksinimi; shënim me marker në vesh, ose mikro çip) për çdo kafshë që është në ternein e komunës.

**Stacioneri** është objekt nga ndërtimi i ndurtë, me lokacion në vend të caktuar në vetëqeverisjen lokale, e paisur me hapsirë bashkohore për trajtim medicinal, si dhe kafazë-boksa për strehimin e kafshëve.

Kafshët e kapura transportohen deri në stacioner ku do të kryhet mbikqyrja klinike, vaksinimi dhe dehementizimi. Të gjithë kafshët e shondosha klinike kalohen në pjesën e përkujdesjes. Identifikimi në teren për cdo kafshë të kapur menjëher evidentohet dhe regjistrohet dhe të tjera të dhëna për kafshën si rasa, gjinia, mosha, karaktere speciale, vendi i kapjes dhe tjera.

Theksohet se me kafshët mund të punojnë vetëm veterinarët dhe persona profesional të cilët i duan kafshët, që nuk kanë frikë ose armiqsi kundrejt kafshëve, persona që kanë kaluar trajnime të caktuara dhe antarë të shoqatës për mbrojtje të kafshëve. Ato me kafshët janë të ndërlidhur që të veprojnë me kujdes dhe në mënyrë humane, duke i përmbrushur standardet e shkruara të Ligjit për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve. Për jetën e kafshëve mund të vlersojë vetëm veterinari. Mardhënia me kafshët mund të jetë lëndë e monitorimit nga ana e shoqatës për mbrojtje të kafshëve, me qëllim që, gjatë evidentimit të parregullsive të caktuara, tu jepet ndihmë për kalimin e tyre (në pajtim me praktikat evropiane në këtë qendër).

### **Sterilizimi (ovariohisterektomija dhe orhiptomija)**

Sterilizimi është masa më efikase e cila, parandalon shumimin e pa kontrolluar, reduktimin e numrit të qenve të braktisur në sipërfaqet publike dhe rregullimin e numrit të popullsisë në qendrën për trajtim. Gjithashtu aplikon kontrollë të pronarëve në shumimin e qenëve të tyre, ashtu që në një periudhë prej 3-4 vitesh ky problem me qentë e braktisur do të zgjidhej plotësisht.

Sterilizimi i kafshëve mashkulllore dhe femrore kryhet pas kontrollit të detajuar klinik. Të gjithë kafshët të cilët pas mendimit nga veterinari, i mbushin kriteret për operim operohen-sterilizohen.

Pas operimit të kryer, kafshët e operuara dërgohen në njësinë e përkujdesit ku do të qëndrojnë deri në rikuperimin e tyre. Në periudhën postoperative kafshët dërgohen në kafazët, gjegjësisht në boksat, ku do të ushqehen rregullisht dhe çdoher nën mbikqyrje nga persona profesional adekuat. Kafazët do të pastrohen rregullisht dhe në mënyrë standarde, do të kryhet

dezinfekzion dhe dezinsektim, ndërsa me nevojë edhe deratizim të përshtatshëm të të gjithë hapsirës stacionare.

Rregullisht para lëshimit të stacionarit nga kafshët do të kryhet vaksinimi kundër tërbimit dhe dehelmentizimit. Kafshët e shënuara me marker në vesh, kthehen në lokacionin e njejtë ku janë kapur më përparë.

## **Eutanzija**

Eutanzija - në përgjithësi është metodë jo efikase për kontrollimin e problemit me kafshët e braktisura në afat të gjatë, dhe është sygjeruar nga ana e Organizatës botërore të shëndetit që mund të realizohet **vetëm dhe ekskluzivisht si eutanzimin human të kafshëve të sëmura të cilat janë afër vdekjes ose të lënduara-në stadium terminal të sëmundjes ose lëndimit; kur gjendja është e pa shërushme, dhe kur është e pamundëshme që të eliminohet dhimbja.** Në atë kontekst, dhe në kornizë të këtij Programi eutanzimi mund të realizohet vetëm si opsjon i fundit në rastet kur nuk egziston mënyrë tjetër për ti ndihmuar një kafshe ose kur nuk ka asnjë të interesuar për të marrë trajtimin e shërimit të mëtutjeshëm të kafshës shumë të sëmurë; si dhe në rastet kur bëhet fjalë për kafshë shumë agresive ekstreme dhe që për të cilin nuk ka shanca për risocionalizim. Vendimin për realizimin e eutanzimit mund ta marrë vetëm veterinari, pas arsyetimit ndaj vendimit në komision prej 3 veterinarësh. Është e nevojëshme argumentimi detali një hapi të tillë në regjistrin e kafshëve të eutanzuara. Kafshët e eutanzuara largohen në mënyrën e një prej ligjeve të shkruara dhe groposen në varreza speciale.

## **Përfshirja e qytetarëve në Programin për zgjidhjen e problemit të kafshëve të pastrehë - futja e statusit " Kujdestar i kafshëve të pastreha"**

Personi fizik i cili në mënyrë vullnetare me mjetet e tijë, siguron ushqim dhe ndihmë veterinarie dhe kujdes për kafshët e braktisura qenë dhe mace në qytetin në të cilin jeton, në mënyrë të vazhdueshme e ndjek statusin, llogaritet si KUJDESTAR i kafshëve të pa strehë qenë dhe/apo mace.

Me angazhimin e tij si vullnetar dhe informatat e ofruara këto njerëz e ndihmojnë Komunën që në mënyrë më kualitative ti realizojë aktivitetet e saj nga lëmia e higjenës në

teritorin e qytetit dhe llogariten , në kuptim të këtijë Programi si komponent i rëndësishëm në kontrollimin e kafshëve të pa strehë të cilët gjenden në sipërfaqet publike të qytetit. Këto persona kujdesen për kafshët e braktisura në pajtim me ligjet aktuale të shkruara në lëminë e medicinës veterinare dhe mirëqenies së kafshëve dhe në të njejtën kohë nuk e rrezikojnë sigurinë dhe rehatinë e qytetarëve dhe mjedisit jetësorë.

Përveq se në mënyrë direkte i ndihmojnë Komunës përmes kujdesit dhe ushqimit të kafshëve, me qka në mënyrë direkte dhe indirekete kontribojnë në mbrojtjen e shëndetit kolektiv dhe kontrollimin e popullsisë të kafshëve të pa strehë, angazhimi i tyre ndihmon edhe në sigurimin e informacioneve (numri i qenve të sterilizuar/jo sterilizuar,numri i kafshëve të ngordhura e tj.) të shërbimeve komunale.

Në interes të komunës është që të mbajë bashkpunim intenziv mes institucioneve shtetërore , NJVL dhe kujdestarët, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, kafshëve, siguria e përgjithshme dhe trajtimi human i kafshëve të pa strehë. Përvojat botërore tregojnë se angazhimi i atyre qytetarëve të cilët kujdesen për kafshët është e pa zavendësueshme, dhe nga rëndësia themelore ( siguron ndihmë vullnetare pa pagesë) për kontrollimin e kafshëve të pa strehë pas kthimit të tyre në rrugë.

### **Personat të cilët kujdesen për kafshët e braktisura janë të evidentuar në sektorin për veprimtari komunale në njësinë e vetëqeverisjes lokale.**

Evidentimi duhet që të mbajë të dhëna për këto persona (emër, numër amze, adresë dhe letër njoftim, komunë, adresë të banimit të përkohësishëm, numër telefoni dhe e-mail adresë, emër të shoqatës për mbrojtje të kafshëve (nëse personi fizik është antarë i shoqatës) si dhe informacione për kafshët e braktisura nga kujdesi i tyre ( numër të mikro çipit te qenëve dhe maceve, lokacionet në të cilët jetojnë)

Kujdestari kafshët e pa strehë i denoncon dhe mund që të kërkojë asistencë nga shërbimet e kapjes me qëllim që kafshët të cilët nuk janë të sterilizuara të kafen dhe tu parashtronen trajtimeve të ovariohisterektimit dhe orhiptomija, dehelmintizimit, identifikimit dhe kthimin e tyre përsëri në teritorin e njejtë, ku do të ndihmojë në procesin e adoptimit në numër më të madh të kafshëve të pa strehë.

Kujdestari i kafshëve të pa strehë duhet ta njoftojë shërbimin kompetent të NJVL për zhdukje ose ngordhje të kafshës të pa strehë për të cilën ai është kujdesur, me qka ajo e dhënë do të evidentohet.

Në pajtim me Programin Komuna i mundëson sterilizim pa pagesë, kastrim, vaksinim, qipovim dhe shërim të të gjithë kafshëve të pa strehë, duke përfshirë edhe kafshët e transportuara nga njerëzit që kujdesen për ta në rrugë - kujdestarët e kafshëve të pastrehë.

Kujdestari i kafshëve të pa strehë, person i cili kryen veprimtari të komunale dhe me vullnetin e tij i ndihmon shoqërisë në të cilën jeton. **Kujdestari i kafshëve të pa strehë në çfardo rasti nuk përgjigjet materialisht as edhe penalisht për dëme (sipas dispozitave për përgjegjsi objektive të LMO) me qka eventualisht do ta bënte kafsha e pa strehë për të cilin ai kujdeset.**

## **Financimi**

Financimi i Programit do të bëhet nga mjetet e parapara në buxhetin e njësisë të vetëqeverisjes lokale.

Çmimi për kapjen e kafshëve të pa strehë dhe qëndrimin e tyre në stacion do të përcaktohet me çmimore të veqanta , të miratuara nga këshillet e komunave konkrete.

Çmimi për trajtimet veterinare të parapara me këtë Program definoohen nga ofertuesi më i volitshëm, i zgjedhur me ankand publik.

**Mjetet të siguruara nga donacion i jashtëm 20.000.000 denarë.**

**Mjetet e parapara në buxhetin e Komunës së Kërçovës për trajtimin e qenvë të pa strehë janë 1.200.000 (një milion e dyqind mijë denarë)**

**Mjetet e parapara për Kampanjë dhe ngritjen e ndërgjegjsisë në vendbanime janë 300.000 (treqind mijë denarë)**

## **Përmbarues**

Përmbarues i aktiviteteve nga ky Program është personi juridik, në bazë të kontratës paraprake të lidhur me Komunën.

## **Mbikqyrje**

Mbikqyrjen ndaj realizimit të Programit e kryen Njësia për mbrojtjen e ambientit jetësorë, në bashkëpunim me Agjensionin për ushqim dhe veterinari ( kompetenca të cilat variojnë nga Ligji për mbrojtje dhe mirëqenie të kafshëve) dhe Shoqata për mbrojtjen e kafshëve. Mbikqyrje kryen edhe Inspektorati gjegjësisht Sektori për punë inspektimi të Komunës përmes inspektorëve për punë komunale, dhe inspektori për mbrojtje të ambientit jetësorë.

## **Edukim dhe informim**

Njëra nga qëllimet e këtijë Programi është edukimi dhe informimi i publikut me aktivitetet e së njejtës. Arsimimi është njëra nga zgjidhjet pozitive afatgjata për kontrollimin e kafshëve të pa strehë, dhe përshkak të sajë është me ndikim fundamental që të promovohen kampanja edukative të drejtuara kundrjetë promovimit të koegzistencës konstruktive dhe të pa pengueshme mes njerëzve dhe kafshëve. Që të arrihen rezultatet e theksuara, është e nevojëshme që në këto kampanja përveq pronarëve të kafshëve të marrin pjesë të gjithë qytetarët (të rritur, rë ri dhe fëmijë) me përfshirjen e të gjithë aktorëve relevant ( p.sh, shkollat dhe mediumet) si dhe personat të cilët punojnë me kafshë. Aspektet kryesore janë si në vijim:

- Të inkuadrohet koncepti i pronësisë së përgjegjëshme, rëndësia e sterilizimit, vaksinimi, identifikimi dhe regjistrimi;
- Të bëhet inkurajimi i pronarëve që ti sterilizojnë, vkasinojnë, ti identifikojnë dhe ti regjistrojnë kafshët e tyre;
- Të inkurajohen dhe të promovohen praktikat më të mira nga vendet fqinjë;
- Të promovohet kujdes i përgjegjshëm për kafshët shtëpiake të „mëhallës,,
- Të edukohen qytetarët dhe të promovohet respektimi i nevojave biologjike, psikologjike, dhe etologjike të kafshëve;
- Të inkurajohet vullnetarizmi në qendër pranim dhe mirmbajtje të përgjegjëshme;
- Të inkurajohet blerja e kafshëve shtëpiake;
- Të inkurajohen njerëzit që të denoncojnë çdo keqtrajtim, keqpërdorim dhe vrasje të kafshëve deri te organet kompetente.
- Të trajnohen njerëzit të cilët punojnë me kafshë (si në qendër pranim ashtu edhe rrugë).

## **Dispozita përfundimtare**

Ky program hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "\_\_\_\_\_ " (Gazeta zyrtare e Komunës \_\_\_\_\_)

**Nr.\_\_\_\_\_**

**\_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_.2023**

**Kërçovë**

**СОВЕТ НА ОПШТИНА КИЧЕВО / KËSHILLI I KOMUNËS SË KËRÇOVËS**

**ПРЕТСЕДАТЕЛ / KRYETAR**

**Скендер Џабири / Skender Xhabiri**

---

